

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6305  
E shtunë, 1 maj 2021  
çmimi 0.40 €

Kosova pashmangshëm  
do të pësojë nga  
ndonjë "non-paper",  
por jo nga Edi Rama

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PARTITË OPOZITARE KANË REAGUAR NDAJ VIZITËS SË  
KRYEMINISTRIT ALBIN KURTIT NË BRUKSEL

# OPOZITA I KËRKON KURTIT TË RAPORTOJË NË KUVEND PËR VIZITËN NË BRUKSEL

## OPINION

LIDHSHMËRIA NË MES TË  
LIGJIT TË GRAVITACIONIT  
TË ISAK NJUTONIT DHE  
RELATIVITETIT GJENERAL  
TË ALBERT AJNSHTAJNIT F. 10

Nga: Naim  
KRASNIQI, fizikan



## AKTUALE



TË HËNËN MBLIDHET KUVENDI,  
TEMË DEBATI ARSIMI  
NË PERIUdhËN E PANDEMISË F. 6

LIROHET PAGESA PËR PROVIMIN  
E JURISPRUDENCËS F. 6

## EKONOMI

BE-ja DEKLAROHET PËR PAGESËN  
E RRYMËS NË VERI, NUK LEJON  
TË SHPENZOHEN MJETET E  
FONDIT PËR VERIUN F. 9



## SPORT

SOT DERBI DRITA - FERONIKELI,  
NESËR LLAPI - PRISHTINA F. 12


Partitë opozitare e kanë kritikuar kryeministrin Albin Kurti për vizitën në Bruksel. Shefat e grupeve parlamentare të opozitës kanë vlerësuar se me këtë vizitë shefi i qeverisë ka filluar dialogun me Serbinë pa treguar transparencë. Ata kanë kërkuar që menjëherë pas kthimit nga Brukseli, kryeministri Kurti të raportojë në Kuvendin e Kosovës për atë që është diskutuar me përfaqësuesit e BE-së për dialogun me Serbinë



**VAKSINAT E  
PRITURA NUK  
SHIHEN ASKUND,  
VAZHDOJNË  
VDEKJET**



**PËRKEQËSOHET  
SITUATA  
EPIDEMIOLOGJIKE  
NË INDI**



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Netanyahu zotohet se do ta hetojë tragjedinë në festival

Jerusalem, 30 prill - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, u zotua se do ta hetojë përplasjen vdekjeprurëse në një festival fetar që shkaktoi dhjetëra viktima. Gjatë vizitës në vendin e ngjarjes, pranë Malit Meron, Netanyahu tha se hetimet serioze "do të sigurojnë që këto lloje katastrofash të mos ndodhin më kurrë". Së paku 45 njerëz u vranë dhe

150 u plagosën në festivalin B'Omer, i cili mbledhi dhjetëra mijëra hebrenj ortodoksë. Është ende e paqartë se çfarë e shkaktoi shtypjen e njerëzve. "Ka pasur skena zemërthyesë këtu. Njerëz që janë shtypur për vdekje, përfshirë fëmijë", u tha Netanyahu gazetarëve. Ai tha se "katastrofa e tmerrshme" është një nga më të këqijat në historinë e Izraelit. Netanyahu, po ashtu, tha se e diela do të jetë ditë zie

kombëtare. Përplasja ndodhi rreth orës 01:00, sipas kohës lokale. Sipas raporteve fillestare, ajo u shkaktua nga shembja e një strukture. Por, burimet policore i thanë më vonë gazetës "Haaretz" se përplasja ka nisur kur disa njerëz kanë rrëshqitur në shkallë dhe kanë bërë që edhe dhjetëra të tjerë të bien pas tyre. Këto raporte, megjithatë, nuk janë konfirmuar.



## Ambasada amerikane në Moskë zvogëlon nivelin e shërbimeve



MOSKË, 30 PRILL - Ambasada amerikane në Moskë njoftoi se po zvogëlon numrin e shërbimeve konsullore për shkak të kufizimeve që i ka vënë Rusia në punësimin e stafit lokal. "Nga 12 maji, Ambasada Amerikane në Moskë do të ofrojë vetëm shërbime emergjente për qytetarët amerikanë dhe një numër shumë të kufizuar të vizave të emigracionit", ka njoftuar Ambasada amerikane në një

deklaratë më 30 prill. Javën e kaluar, presidenti rus Vladimir Putin urdhëroi qeverinë të përpilonte një listë të shteteve "jomiqësore" si dhe nënshkroi një ligj për ta kufizuar numrin e stafit lokal që punon në misione të huaja diplomatike dhe agjenci të tjera. Uashingtoni dhe Moskë kanë hyrë në një fazë të re të tensioneve. Shtëpia e Bardhë ka shpallur sanksione ndaj Rusisë për

shkak të sulmeve kibernetike, ndërhyrjeve në zgjedhje dhe kërcënimeve ndaj ushtarëve amerikanë në Afganistan. Një çështje tjetër që ka prekur raportet mes dy vendeve është burgosja dhe shëndeti i kritikut të Kremlinit, Aleksei Navalny, pastaj situata në Ukrainën lindore dhe akuzat e përfshirjes ruse në një shpërthim vdekjeprurës në një depo municionesh në Republikën Çeke më 2014.

## Përkeqësohet situata epidemiologjike në Indi


NJU-DELHI, 30 PRILL - Situata epidemiologjike në Indi po përkeqësohet. Në spitale ka mungesë të shtretërve, oksigjenit dhe ilaçeve. Policia në kryeqytetin e Indisë Delhi u ka kërkuar autoriteteve lokale të identifikojnë më shumë lokacione që mund të përdoren si krematoriume për viktimat e Covid-19. Të enjten autoritetet indiane thanë se numri i të infektuarve ka kaluar mbi 18 milionë ndërsa brenda ditës janë regjistruar 386 452 raste të reja me Covid-19, numri më i lartë i regjistruar

ndonjëherë brenda një dite. Numri i përgjithshëm i të vdekurve në Indi zyrtarisht është mbi 200 000, megjithëse ekspertët besojnë se shifra mund të jetë shumë më e lartë. Qeveria qendrore e Indisë po përballet me kritika në rritje për trajtimin e pandemisë dhe për lejimin e tubimeve zgjedhore dhe festivaleve fetare. Situata e tmerrshme e pandemisë në vendin me 1.3 miliard njerëz po shkakton shqetësim se një skenar i tillë mund të ndodhë edhe diku tjetër.

Afrika po "shikon me shqetësim" atë që po ndodh në Indi, u tha gazetarëve John Nkengasong, drejtor i Qendrës për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC). "Nuk mund të injorojmë atë që po ndodh në Indi. Ne nuk kemi personel të mjaftueshëm shëndetësor dhe oksigjen", ka thënë ai. Mbi 40 vende në botë kanë thënë se do ta ndihmojnë Indinë në përballje me situatën e pandemisë. Dërgesa e parë e furnizimeve nga ShBA-ja ka mbërritur tashmë.



## Hungaria lehtëson masat për të vaksinuarit



BUDAPEST, 30 PRILL - Hungaria do t'i lehtësojë masat e izolimit nga koronavirusi për njerëzit e vaksinuar. Kryeministri Viktor Orban tha të premtën se numri i të vaksinuarve me një dozë është afër 4 milionë - çfarë paraqet rreth 40 për qind të popullsisë së përgjithshme hungareze. "Në të kaluarën e kemi mbrojtur veten duke u mbyllur dhe, në këtë mënyrë, kemi ngadalësuar përhapjen e virusit. Por, tani jemi në sulm", ka thënë Orban për radion

publike hungareze. Ai ka shtuar se Hungaria ka doza të mjaftueshme të vaksinave për ta imunizuar secilin që është regjistruar për vaksinim. "Vaksina është sikur jeleku anti-plumb; virusi tërhiqet prej tij", ka deklaruar Orban. Me masat e reja, të vaksinuarit, që kanë kartën e imunizimit të lëshuar nga autoritetet, mund të hyjnë në restorante brenda, hotele, teatro, kinema, banja, palestra, biblioteka, muze,

kopshte zoologjike dhe vende të tjera rekreative, nisur nga 1 maji. Orari i punës për bizneset gjithashtu do të zgjatet deri në orën 23:00. Hungaria mbështetet kryesisht në vaksinat nga Kina dhe Rusia të cilat nuk janë miratuar nga Agjencia Evropiane e Barnave. Sipas shifrave të Universitetit "Johns Hopkins", Hungaria ka regjistruar mbi 779 000 raste me koronavirus dhe mbi 27 000 viktima.



# Vaksinat e pritura nuk shihen askund, vazhdojnë vdekjet

PRISHTINË, 30 PRILL - Në Kosovë ende nuk kanë arritur dozat e reja të vaksinës kundër koronavirusit të cilat ishin paralajmëruar se do të vinin gjatë muajit prill. Në Ministrinë e Shëndetësisë nuk janë përgjigjur në pyetjet e "Radios Evropa e Lirë" lidhur me vonesat për sigurimin e dozave të reja të vaksinave kundër Covid-19. Kohë më parë në Ministrinë e Shëndetësisë janë deklaruar se UNICEF-i iu kishte bërë me dije se 76 800 doza të tjera të vaksinës mund të vijnë përmes COVAX-it, të ndara në dy kontingjente: njëri në fund të prillit e tjetri gjatë majit.

Gjithashtu, kjo ministri ka thënë se 95 mijë doza të vaksinës "Pfizer" nga Bashkimi Evropian do t'i jepen Kosovës në periudhën maj-gusht.

Ekspertë shëndetësorë, infektologë dhe partitë opozitare, i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të veprojnë në mënyrë urgjente për sjelljen e vaksinës kundër koronavirusit, në të kundërtën qytetarët po rrezikohen nga infektimet dhe vdekjet që po shkakton Covid-19.

Hana Xhemajli, specialiste për hulumtime të politikave globale shëndetësore, tha për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova është e rrezikuar për faktin se është shteti i fundit që ka dozën kaq të vogël të vaksinave dhe i fundit që nuk e ka siguruar një kontratë për blerje të vaksinës. "Sa po rrezikohemi është e vështirë të matet, por rreziku është mes nesh, sidomos për faktin që edhe popullata nuk është duke i respektuar rregullat për



parandalimin e përhapjes së koronavirusit, si maskat dhe distanca fizike në mënyrë strikte", ka deklaruar Xhemajli.

Në Kosovë, që nga paraqitja e rasteve të para me Covid-19 në mars të vitit 2020 dhe deri më 29 prill 2021, 2 162 pacientë kanë vdekur nga koronavirusi, ndërsa të infektuar janë regjistruar mbi 100 mijë raste.

Vaksinimi në Kosovë ka nisur në fund të muajit mars, por pas administrimit të 24 mijë dozave të vaksinës "AstraZeneca", të cilat Kosova i pranoi si donacion përmes programit COVAX të Organizatës Botërore të

Shëndetësisë, vaksinimi është ndërprerë deri në arritjen e dozave të tjera.

Infektologu Ilir Tolaj thotë për "Radion Evropa e Lirë" se çdo ditë që shtyhet vaksinimi i popullatës, është një rrezik potencial që dikush të sëmuret dhe të vdesë. "Në kohën kur nuk kanë qenë të zbuluara vakcina, mundësia e vetme ka qenë që të aplikohen masat për parandalimin e përcjelljes së infeksionit dhe masat për mjekimin e të sëmurëve. Në këtë kohë, kur vakcina me muaj të tërë është në dispozicion, jo vetëm një vaksinë, por mbi nëntë lloje të vaksinave në nivel botëror, është absurde që Kosova ende

nuk ka siguruar vaksinat", ka thënë Tolaj.

Mjaft kritik për mospërgjigjen e dozave të reja të vaksinës kundër Covid-19 janë edhe partitë opozitare në Kosovë.

Shemsedin Dreshaj, nga partia opozitare Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, njëherësh edhe anëtar i Komisionit për Shëndetësi në Kuvendin e Kosovës, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se autoritetet duhet të vënë kontakte me kompanitë farmaceutike, në mënyrë që të përshpejtohet ardhja e vaksinës. "Jemi vonuar. Çdo ditë po rrezikohet jeta e popullatës në mungesë të vaksinave. Virusi është në

ambientet tona dhe është duke qarkulluar, përkundër faktit që kemi një rënie të rasteve të reja, por vdekjet po ndodhin", ka thënë Dreshaj. Në mes të të vaksinuarve me 24 mijë dozat e para të vaksinës kundër koronavirusit, përfshihen punonjësit shëndetësorë, të moshuarit dhe ata me sëmundje kronike. Sipas kryetarit të Federatës së Sindikalistëve të Shëndetësisë së Kosovës, Blërim Sylja, me këtë dozë të vaksinës janë vaksinuar afër 5 000 punëtorë shëndetësorë që, sipas tij, paraqet një numër shumë të vogël. Ai thotë se ka ekzistuar një hezitim i mjekëve për t'u vaksinuar me vaksinën "AstraZeneca", e që kjo ka dhënë një mesazh shumë të keq te popullata. Për këtë hezitim, ai thotë të jetë shkaktuar nga keqinformimi dhe strategjia jo e duhur e autoriteteve.

Po ashtu, ai thotë që një grup i profesionistëve shëndetësorë, besojnë se do të vaksinohen me vaksinën "Pfizer". "Çdo ditë që vonohemi në sjelljen e vaksinës dhe në vaksinim, vonohemi të shpëtojmë një jetë. Njëzetekatër mijë dozat e administruara është një pikë ujë në oqean. Jemi duke u vonuar pasi që fatkeqësisht politikanët tanë nuk janë konsekuentë. Më e keqja është se këtu po mbizotëron jotransparenca. Virusi dhe sëmundja nuk ndahet në periudha qeverisëse", ka deklaruar Sylja.

Ndryshe, sipas planit shtetëror të imunizimit, deri në fund të vitit Qeveria e Kosovës planifikon që të vaksinohet deri 70 për qind të popullatës në Kosovë.

## Mbi 8 000 raste aktive me Covid në Kosovë

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 PRILL - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 2 810 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultuan 202 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 11 raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Ferizaj dy raste (87, 77 vjeç), Podujevë dy raste (84, 37 vjeç), Prishtinë dy raste (76, 64 vjeç), Drenas një rast (90 vjeç), Gjakovë një rast (79 vjeç), Mitrovicë një rast (78 vjeç), Skenderaj një rast (79 vjeç), Viti një rast (65 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 105 188 raste nga 533 764 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 2 173 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 646 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është

gjithsej 94 174 raste, kurse numri i rasteve aktive është 8 841.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 52 raste, Podujevë 14 raste, Skenderaj 14 raste, Mitrovicë 12 raste, Ferizaj 11 raste, Gjiilan 11 raste, Prizren 9 raste, Fushë-Kosovë 8 raste, Suharekë 8 raste, Gjakovë 7 raste, Klinë 6 raste, Obiliq 6 raste, Pejë 6 raste, Drenas 5 raste, Lipjan 5 raste, Malishevë 5 raste, Vushtrri 5 raste, Rahovec 3 raste, Deçan 2 raste, Istog 2 raste, Kaçanik 2 raste, Novobërdë 2 raste, Shtime 2 raste, Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Hani i Elezit dhe Leposaviq.



AMBULANCA PËR  
**CORONAVIRUS**





PARTITË OPOZITARE KANË REAGUAR NDAJ VIZITËS SË KRYEMINISTRIT ALBIN KURTI NË BRUKSEL

# Opozita i kërkon Kurtit të raportojë në Kuvend për vizitën në Bruksel

Partitë opozitare e kanë kritikuar kryeministrin Albin Kurti për vizitën në Bruksel. Shefat e grupeve parlamentare të opozitës kanë vlerësuar se me këtë vizitë shefi i qeverisë ka filluar dialogun me Serbinë pa treguar transparencë. Ata kanë kërkuar që menjëherë pas kthimit nga Brukseli, kryeministri Kurti të raportojë në Kuvendin e Kosovës për atë që është diskutuar me përfaqësuesit e BE-së për dialogun me Serbinë

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 30 PRILL - Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e kanë kritikuar kryeministrin Albin Kurti për vizitën në Bruksel, ku me zyrtarët evropianë kanë diskutuar për vazhdimin e dialogut me Serbinë.

Shefat e grupeve parlamentare të opozitës kanë vlerësuar se vizita e Kurtit në Bruksel i ka shërbyer kryekëput fillimit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ata kanë thënë se për këtë vizitë Kurti është treguar jotransparent dhe duhet të raportojë në Kuvendin e Kosovës sapo të kthehet nga Brukseli.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se kryeministri nuk është as i sinqertë dhe as transparent në

raport me procesin e dialogut. "Ne nuk kemi pranuar ende asnjë ftesë nga z. Kurti. Mendoj se z. Kurti në rast se do ta kishte seriozisht konsultimin me opozitën për këtë çështje do të duhej që ta bënte para se të udhëtonte në Bruksel. Vizita e tij në Bruksel i ka shërbyer kryekëput fillimit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Tahiri gjatë një konferencë për media.

Ai ka thënë se qeveria duhet ta

hartojë një platformë për dialog. "Z. Kurti duhet ta bëjë me dije agjendën e tij, platformën dhe temat që Qeveria e Kosovës do t'i paraqesë në Bruksel në takimet e radhës në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ne nuk po shohim transparencë dhe sinqeritet nga ai në këtë proces", ka deklaruar Tahiri pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Kurse shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka vlerësuar se Kurti ka shkuar në Bruksel pa e pyetur Kuvendin e Kosovës. Ai ka thënë se kryeministri sapo të kthehet nga atje duhet të raportojë para deputetëve. "Kurti e ka detyrë kushtetuese që ta përfaqësojë vendin jashtë. Po ashtu, e ka detyrë kushtetuese që të merret me bisedimet me Serbinë. Jo

Kurti si individ, por si kryeministër. Sa iu përket deklaratave nga Brukseli, janë të parakohshme që t'i komentojmë. Në këtë situatë, e rëndësishme është që ka sistem i cili e obligon që ai nga kthimi i tij të raportojë në Kuvend. Kjo ka qenë kërkesë e LV-së me një rezolutë. Ai ka shkuar në Bruksel pa e pyetur Kuvendin. Kur të kthehet nga Brukseli duhet të raportojë në Kuvend", ka thënë Gashi.

Ai ka thënë se ish-kryeministri nga radhët e LDK-së, Avdull Hoti, ia ka dorëzuar të gjithë dosjen e dialogut kryeministrit Kurti. "Hoti i ka dorëzuar Kurtit një dosje të plotë dhe kjo është një prej arsyeve pse e ka pritur në zyrë. Kurti po thotë të pavërteta në lidhje me këtë



# Kurti: “Non-papers”-at mund ta kenë prejardhjen në Beograd dhe Moskë

PRISHTINË, 30 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pretendon se dokumentet “non-paper” të publikuara ditët e fundit nga mediat në Ballkan mund ta kenë prejardhjen në Beograd dhe Moskë. “Nuk besoj se autorët e këtyre janë kryeqytetet perëndimore, sigurisht jo ShBA-ja dhe as ato evropiane. Besoj se kjo vjen nga Beogradi dhe verilindja. Është interes i Federatës Ruse ta përdorë Ballkanin Perëndimor për ta sulmuar Bashkimin Evropian dhe NATO-n”, ka deklaruar Kurti në një intervistë për një grup gazetarësh të cilët po e përcjellin vizitën e tij në Bruksel.

Që nga mesi i muajit prill e deri më tash, në media janë publikuar dy të ashtuquajtur “non-paper”, si dokumente të pretenduara në të cilat flitet për qasje të ndryshme për zgjidhjen e kontestit Kosovë -

Serbi. “Non-paperi” i parë, i publikuar më 15 prill, pretendohet të jetë i kryeministrit të Sllovenisë, Janez Jansha, i dërguar për Këshillin e Evropës. Ai përmban propozimin e supozuar për ricaktimin e kufijve në Ballkanin Perëndimor, si një mënyrë për ta zgjidhur problemin kronik ndërmjet gjashtë vendeve në rajon. Këto pretendime janë hedhur poshtë nga Jansha, por edhe nga zyrtarë të Bashkimit Evropian.

Më 27 prill në disa media në Kosovë është publikuar një “non-paper” tjetër, i cili është pretenduar të jetë hartuar nga Gjermania dhe Franca dhe i cili flet për themelimin e të ashtuquajturit “distrikti autonom i Kosovës së Veriut” dhe për njohjen e integritetit dhe sovranitetit territorial në mes të Kosovës dhe Serbisë. Gjermania e ka hedhur poshtë vërtetësinë e “non-paperit” që

## Çfarë është “non-paper”?

Në gjuhën e institucioneve evropiane, “non-paper” është dokument joformal, zakonisht pa theksim të qartë, i cili ekspozohet në negociata të mbyllura brenda institucioneve të BE-së, veçanërisht në Këshillin e Ministrave, në mënyrë që të kërkohet marrëveshja për ndonjë çështje të kontestuar procedurale ose politike. “Non-paper” është formë e zakonshme komunikimi e një ose më shumë anëtarëve të BE-së rreth një çështjeje të caktuar.

u tha se është hartuar nga ajo dhe Franca.

I pyetur lidhur me këto dokumente, përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe siguri i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, tha se ai nuk punon me “non-paper” dhe i quajti dokumente fantazmë.

Borrelli këto komente i bëri të enjten pas takimit me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në Bruksel. Në anën tjetër, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka deklaruar më 27 prill se “non-paper” i

publikuar nga mediat në Prishtinë e ka bërë dikush që është “shumë shumë i mençur”. “Ka gjëra të cilat do t’u kishin pëlqyer serbëve, por aty është edhe një gjë, të pranohet pavarësia e Kosovës e që është shumë e keqe për serbët”, ka deklaruar Vuçiqi gjatë një vizite në jug të Serbisë.

Ai shtoi se publikimi nuk është bërë pa arsye. Vuçiqi tha se do t’i analizojë porositë për palën serbe dhe palën tjetër, por shtoi se për Serbinë është e papranueshme njohja e pavarësisë së Kosovës.



çështje dhe këto të pavërteta do të dekonspirohen nga Hoti. Ka një proces dorëzimi të nënshkruar. Kurti i ka të gjitha dokumentacionet për dialogun. Nëse ka nevojë që të bëhen publike atëherë do t’i bëjmë publike”, është shprehur Gashi. Edhe AAK-ja e konsideron si shumë të rëndësishëm raportimin e kryeministrit Kurti në Kuvend për vizitën në Bruksel.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se për të pasur sukses në procesin e dialogut me Serbinë duhet qasje serioze. “AAK-ja e konsideron shumë të rëndësishëm konsultimin me partitë opozitare dhe informimin në Kuvend. Askush nuk ka ekskluzivitet në këtë temë, pra as Kurti dhe askush tjetër. Për të pasur sukses në këtë temë duhet të ketë qasje serioze dhe joselektive”, ka thënë Tahiri.

Ai ka bërë me dije se kryeministri Kurti në zyrën e tij ka raport për çdo marrëveshje që është arritur në Bruksel. “Kurti e ka dokumentin e hartuar në kryeministri, veç duhet ta kërkojë. E ka raportin e të gjitha marrëveshjeve të deritanishme”, ka thënë Tahiri. Kryeministri Albin Kurti për dy ditë radhazi ka qëndruar në

Bruksel, ku është takuar edhe me përfaqësuesin e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri të Bashkimit Evropian, Josep Borrell dhe emisarit e BE-së për dialogun, Miroslav Lajčak, me të cilët është pajtuar që procesi i dialogut me Serbinë të fillojë në muajin qershor.

Pas kësaj vizite, Kurti ka deklaruar se për procesin e dialogut më shumë ka mësuar në Bruksel se në Kosovë. Kjo ka nxitur edhe reagimin e ish-

kryeministrit Avdullah Hoti.

Në profilin e vet në “Facebook”, Hoti ka përmendur dokumentet që ia ka dorëzuar kryeministrit Kurti. “Të gjitha dokumentet e dialogut në qeverinë paraprake i janë dorëzuar kryeministrit aktual me rastin e dorëzimit pranimit të detyrës. Një folder i protokolluar formalisht përmban në veçanti këto dokumente: Pozicioni i Republikës së Kosovës në dialog me Serbinë, raport i detajuar (29

faqe) mbi kronologjinë e të gjitha zhvillimeve lidhur me dialogun (samitet, takimet në Bruksel të nivelit të lartë, takimet e koordinatorëve për dialog, vizitat në Prishtinë të ndërmjetësimit për dialog, komunikimi me opozitën, koordinimi me Uashingtonin, vizitat në vendet e Quintit për konsultim lidhur me dialogun, takimet me ambasadorët e Quintit dhe të vendeve të BE-së në Prishtinë lidhur me dialogun,

përgatitjet e bëra etj.). Pra, aty janë të gjitha dokumentet e dakorduara në Bruksel në disa runde të dialogut”, ka thënë Hoti.

Rinisja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të ndodhë para fundit të qershorit, ka bërë me dije përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe siguri i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, pas takimit në Bruksel me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.



## Lirohet pagesa për provimin e jurisprudencës

PRISHTINË, 30 PRILL (ER) - Ministra e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se ka marrë vendim lidhur me pagesën për paraqitjen e provimit të jurisprudencës. Ajo përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook",

ka shkruar se pagesa për paraqitjen e provimit të jurisprudencës është ulur 50 për qind. "Në kuadër të kompetencave të mia, sot kam ndryshuar vendimin lidhur me pagesën e kandidatëve për paraqitjen e provimit të

jurisprudencës. Kemi ulur deri në 50 për qind këto pagesa. Nga shuma 100 euro sa kanë paguar deri tani, kemi vendosur që kandidatët që hyjnë në Provimin të Jurisprudencës ta paguajnë shumën prej 50 eurosh. Ndër

prioritetet tona është edhe krijimi i kushteve sa më të mira për juristët e rinj të cilët nesër synojnë të jenë pjesë e sistemit të drejtësisë dhe që do të japin kontribut në interesin publik", ka shkruar ministria Haxhiu.



## Të hënën mblidhet Kuvendi, temë debati arsimit në periudhën e pandemisë

PRISHTINË, 30 PRILL (ER) - Kuvendi i Republikës së Kosovës, të enjten, më 6 maj, në orën 10:00, do të mblidhet në seancë të rregullt plenare. Kështu vendosi Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarë të grupeve parlamentare, të drejtuar nga kryekuvendari Glauk Konjufca.

Në seancën e të enjtes, pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, deputetët do të

debatojnë lidhur me organizimin e arsimit në të gjitha nivelet në situatën e pandemisë së virusit Covid-19. Pas debatit, pikë e radhës do të jetë shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në lidhje me kërkesën e NP KOSTT për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës.

Në këtë mbledhje kryesia ka



miratuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2024 konform

rekomandimit të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe vendosi ta bëjë shpalljen e konkursit për dy pozita të lira në këtë këshill nga radhët e komuniteteve joshqiptare, si dhe shpalljen publike për një anëtar të Bordit për Ankesa të Mediave. Kryesia ka diskutuar edhe për formimin e delegacioneve të Kuvendit të Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare për Legjislaturën VIII dhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e saj.

## Shërbimi Korrektues lehtëson masat ndaj Covidit



PRISHTINË, 30 PRILL (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) ka njoftuar se nga data 5 maj secili i burgosur do të ketë mundësi të pranojë në vizitë dy vizitorë të rritur dhe tre fëmijë. Familjarët gjatë

vizitës së tyre janë të obliguar t'i respektojnë masat kundër Covid: distancën sociale, vendosjen e maskës dhe dezinfektimin e duarve. Ndërsa nga data 10 maj do të fillojë lejimin e të dënuarve të

cilët plotësojnë kushtet ligjore për shfrytëzimin e fundjavës në shtëpi. Pas kthimit nga fundjava, të burgosurit do t'i nënshtrohen fazës së karantinimit në periudhë kohore prej së paku shtatë

ditësh. Shërbimi Korrektues i Kosovës ka filluar lehtësimin e masave në bashkëpunim me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve. Shërbimi Korrektues i Kosovës

ka njoftuar se do ta vazhdojë bashkërendimin institucional me institucionet relevante të Republikës së Kosovës dhe do të mbajë të informuar opinionin publik rreth hapave në vazhdim.

## Auditori i Përgjithshëm dorëzon në Kuvend raportin vjetor të performancës për vitin 2020

Prishtinë, 30 prill (ER) - Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, të premtën është pritur në takim nga kryetari i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere (KBPT), Armend Muja. Osmani e ka informuar Mujën për finalizimin e procesit të auditimit për

sezonin 2020/21 dhe për vështirësitë me të cilat është duke u ballafaquar ZKA-ja për realizimin e planit të auditimit. Ata kanë biseduar për modalitetet e bashkëpunimit ndërmjet ZKA-së dhe KBPT-së me qëllim që rezultatet e auditimit ta përmirësojnë

qeverisjen dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Me këtë rast, Auditori i Përgjithshëm/Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) e ka dorëzuar në Kuvendin e Kosovës edhe raportin vjetor të performancës për vitin 2020. Raporti Vjetor i performancës përmban informata të

rëndësishme rreth performancës së institucionit të Auditorit të Përgjithshëm për përmbushjen e obligimeve të tij kushtetuese e ligjore, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).





# Kosova pashmangshëm do të pësojë nga ndonjë “non-paper”, por jo nga Edi Rama



Behxhet Sh. SHALA -  
BAJGORA

**Negociatat nën rrebeshin e “non-paperëve”:** Bashkësia ndërkombëtare, përkatësisht BE-ja dhe ShBA-ja, po insistojnë për vazhdimin e negociatave me Serbinë, ndërkohë që Serbia nuk e çanë pallën për këtë. Kryeministri Kurti, në lojën e shahut politik, bëri përpjekje që negociatat me Serbinë t'i trajtojë si: “biren e fundit të kavallit”. Nëse i dhezë, mirë, nëse jo, e vazhdojmë sipas Borrellit dhe mashtruesit ordiner, Miroslav Lajçak. Pata menduar se më të keqe për Kosovën se Mogerinin, nuk mund ta gjeni as në Shumadi e tash, pas këtij supermashtruesi të quajtur Lajçak, Mogerini del të jetë si: “Shën Mëria e pavirgjër”. Ngadalë, nën presionin ndërkombëtar, vazhdimi i bisedimeve me Serbinë pësoi ndryshim në listën e prioriteteve të kryeministrit të Kosovës, tash është thuaja i pari në këtë top-listë. Në lojërat që e shoqërojnë prapaskenën ku rëndom luhen lojëra të ndyra e për të cilat publiku i thjeshtë merr vesh pasi të jetë kryer puna dhe, mbase, as atëherë, u gjuajt një datë e mundshme për takimin midis kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit dhe kryepeshkopit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, 11 maji 2021.

Në ndërkohë kryeministri Kurti shkoi në Bruksel me ekspertin për çështje ekonomike të cilin, me një alkimi që e zotëron vetëm Albin Kurti, e shndërroi në ekspert për integritet evropian dhe bisedime me Serbinë e që për mua dhe besoj edhe për shumicën është befasi e dorës së parë aq më parë që Besnik Bislimi, deri më tani ishte i njohur si tabula rasa për integritet evropian dhe bisedime me Serbinë. Disi jam i bindur që tani Besnik Bislimi është njeriu më i besuar i kryeministrit Kurti dhe njeriu më i përshtatshëm, nëse kërkohet, të sakrifkohet, pa derdhur një pikë lot për të, si djali i hazreti Ibrahimit! Në treshen përfaqësuese të Kosovës ishte edhe urryesja më e madhe e të burgosurve politikë shqiptarë, e luftës së UÇK-së dhe sidomos e Bacë Adem Demaçit, tash e katapultuar si ministre e Jashtme

e Kosovës, Donika Gërvalla-Shvarc. Kryeministri Kurti e refuzoi takimin e 11 majit me arsyetim (të argumentuar) se nuk ka pasur ftesë zyrtare për këtë takim dhe se, sipas traditës kosovare: “vetëm në varrim dhe në kryeshëndosh shkohet pa ftesë...”. Tash u caktua një kohë tjetër mirëpo, sinjor Borelli i ftoi në iftar udhëheqësit e vendeve ballkanike dhe se Albin Kurti, si mysliman i madh politik, nuk ka asnjë arsye ta refuzojë këtë ftesë të përbashkët. Sigurisht se gjatë marrjes së abdestit apo faljes së teravive në Bruksel, në ndonjë korridor edhe mund të takohen “krejt rastësisht” Albin Kurti me Vuçiqin, pa u bërë, as e madhe e as lajm i ditës. Tash, pasi kryeministri Kurti e refuzoi propozimin e Borellit, u krijuan të gjitha kushtet t'i aktivizojmë çiftelitë, sharkitë dhe tupanat dhe të folklorizojmë këtë veprim të jashtëzakonshëm në mbrojtje të shtetit dhe dinjitetit. Jemi të njohur për këtë, nuk ka mbetur kush pa u përdredhur nëpër telat e çiftelisë. Të na rrojë artistja e njohur dhe me renome ndërkombëtare, Linda Morina. Kryeministri Kurti i ka marrë seriozisht bisedimet me Serbinë duke e bërë një ekip negociatorësh, të maskuar si ekip i ekspertëve dhe të cilët më parë, qoftë si “ekspertë” apo edhe si ambasadorë, 100 për qind kanë qenë nën komandën e Hashim Thaçit. Të gjithë këta në atë kohë janë fyer dhe janë sharë kurse tani janë të nderuar dhe të çmuar, patriotë dhe ekspertë që do t'i qëndrojnë prapa, anash dhe, nëse e kërkon nevoja, me mendjen e tyre por edhe trupin, do t'i dalin para kryeministrit Kurti për ta mbrojtur nga të gjitha rreziqet. Këtu është joserioziteti i vlerësimit tonë për personalitete të caktuara sepse nuk i referohemi kompetencës profesionale, por i përmbahemi logjikës së grigjës. Varësisht nga ogji, të tillë e kemi vlerësimin. Tash është në krye të proceseve Albin Kurti dhe këta që janë pjesë e grigjës negociuese janë të mirë, shumë të mirë, madje edhe të mrekullueshëm. Ju kujtohet më parë se kur Albin bënte opozitë, disa që sot e hyjnizojnë, e quanin pjellë komuniste e baballarëve Adem Demaçi dhe Rexhep Qosja. Po të njëjtët sot i kanë ndryshuar krejtësisht mendimet, qëndrimet dhe vlerësimet. Lëvyrës të noterizuar! Ekipi i Ekspertëve do të konsiderohet shumë i hendikepuar nëse e mënjanon nga platforma e bisedimeve filozofinë kombëtare dhe politike të shokut Rrahman Morina!

**“Non-paper”, fluturojnë, fluturojnë, duket se ia huqin, por në fund e qëllonjë:** Kohët e fundit janë shpeshuar si shumë propozimet për zgjidhje përfundimtare midis Serbisë dhe Kosovës në formën e “non-paper”, ku nuk nënshkruhet autori apo autorët por se, pa asnjë dyshim, prapa tyre qëndrojnë shtete të fuqishme politike e që nuk duan të identifikohen në këtë fazë të ndjeshme të procesit. Të gjitha këto propozime e favorizojnë Serbinë duke vënë në diskutim, qoftë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, statusin politik të Kosovës dhe integritetin territorial të saj. Në asnjë propozim, as në miligram nuk diskutohet për statusin politik të Serbisë dhe integritetin territorial të saj!!! Dhe me këto propozime synohet të arrihet një zgjidhje e qëndrueshme????! Më herët ishte një propozim gjerman që parashihte që të konservohej gjendja ekzistuese për 20 vjet e pastaj serbët me referendum do të deklaroheshin si dhe me kënd duan të jetojnë apo të bashkohen. Kjo mundësi asnjëherë nuk u ishte ofruar qytetarëve shqiptarë të Kosovës, madje në Kushtetutën e Kosovës referendumi përjashtohet si mjet demokratik për shprehje të vullnetit të shumicës. Një “non-paper” parashihet që Yajednica të ketë elemente konstituive shtetërore, që Kisha Ortodokse të jetë shtet mbi shtet në Kosovë dhe të përligjet një entitet politik dhe etnik i quajtur Kosova Veriore në vend të emërtimit Veriu i Kosovës. Një tjetër “non-paper” parashihet që veriu i Kosovës ta ketë statusin e Tirolit Jugor apo Alto Adixhes në Itali. Madje, një hermafrodite politike, Viola von Cramon, deklarohet haptazi për këtë mundësi duke deklaruar se do të ishte një zgjidhje pozitive dhe për këtë keqpërdorë disa “argumente” sikur: “Roma ka treguar bujari të madhe në Tirolin

Jugor, prandaj e ka eliminuar ndjenjën separatiste të qytetarëve italianë me përkatësi etnike gjermane që e përbëjnë shumicën absolute...”, dhe marrëzira të tjera që na bëjnë shumë të qartë se këta “non-paper”, kanë autorë, kanë adresë dhe e kanë një qëllim. Territori i Tirolit Jugor i ka 115 komuna e jo 4 komuna sa ka në veri të Kosovës. Ndërkaq, po të sillej Serbia në raport me Kosovën, si sillet Austria me Italinë, ky propozim edhe do të mund të diskutohet. Kështu siç po shkojnë punët, kur Serbia kontrollon 100 për qind veriu e Kosovës dhe serbët e tjerë të Kosovës përjashtuar këtu Nenad Rashiçin, çdo diskutim ku mund të flitej për status politik dhe territorial të Kosovës do të ishte vetëvrasje dhe zhbërje e Kosovës në të gjitha aspektet.

Bashkësia ndërkombëtare po sillet në mënyrë shumë bujare me një shtet puro kriminal siç ka qenë dhe është Serbia duke bërë përpjekje ta gjytojë dhe defunksionalizojë Kosovën, në të gjitha aspektet. Pse nuk ua dhanë statusin e Tirolit Jugor shqiptarëve të Maqedonisë, Malit të Zi dhe të Serbisë?! Këta s'duan ta trajtojnë këtë çështje si rast të izoluar vetëm për Kosovën. Po duket se këto, në një mënyrë apo tjetër duan ta imponojnë si zgjidhje përfundimtare. Nëse kryeministri Albin Kurti do të jetë në gjendje t'i përballojë këto, do të shndërrohet në një burrështetas të vërtetë dhe duhet të përkrahet nga të gjithë, pa përjashtim përkatësi politike. Por, kam një frikë se, herët a vonë do të goditemi nga ndonjë “non-paper”. Të gjitha zhvillimet shkojnë në atë drejtim!

**Zgjedhjet në Shqipëri:** Nuk kam pasur asnjë dyshim se Edi Rama do të jetë fitues i zgjedhjeve në Shqipëri për faktin se nuk ka pasur kundërshtarë e as alternativë. Nuk ishin alternativa për Shqipërinë, Lulzim Basha, Sali Berisha, Ilir

Meta dhe Monika Kryemadhi, prandaj Rama e pati shumë më lehtë. Edi Rama duhet të urohet nga të gjithë për fitoren aq më parë që në fjalimin pas fitores e që ishte i jashtëzakonshëm nuk shfaq asnjë urrejtje, mosdurim apo nuk refuzoi bashkëpunim me askënd. U tregua shumë bujar në ofertën ndaj PD-së dhe Lulzim Bashës. Lulzim Basha, në fjalimin e tij e bëri krejtësisht të kundërtën ndaj PS-së, fituese e zgjedhjeve dhe në veçanti ndaj Ramës. Kishte një fjalim acarues, hakmarrës dhe mohues ndaj çdo bashkëpunimi. Shumë qytetarë të Kosovës votuan në Shqipëri pasi kishin shtetësi shqiptare. Në rrethana të acarimit të skajshëm midis dy poleve politike në Shqipëri, PS-së dhe PD-së, votuesit nga Kosova është dashur të tregohen më të kujdesshëm dhe më të përmbajtur. Pas bërjes publike të rezultateve të zgjedhjeve të 25 prillit, Edi Rama është dashur të urohet menjëherë për fitoren, së pari nga Kosova sikur edhe nga parti të politike në Shqipëri. Edi Rama nuk ka punuar dhe nuk punon kundër Kosovës, vetëm mund ta ndihmojë Kosovën. Në Shqipëri, për dallim nga Kosova, mungon kultura që fituesi i zgjedhjeve të urohet ende pa u bërë publike rezultati përfundimtar i zgjedhjeve. Kosova e ka krijuar këtë kulturë dhe është shembull i mirë në rajon. Urime Edi Ramës për fitore të merituar! As Basha nuk është humbës sepse rriti votat e PD-së e që nuk mund të thuhet edhe për LSI-në që humbi shumë mandate. Ta kultivojmë frymën e bashkëpunimit e jo të konfrontimit. Këtë duhet ta bëjnë udhëheqësit institucionalë të Kosovës, në radhë të parë. Kosova e ka shumë problem pa përkrahjen politike të Shqipërisë dhe jemi me shumë fat që e kemi Shqipërinë sikur që do të ishim edhe me më shumë fat nëse edhe ne bëhemi Shqipëri. Shpresoj shumë se kështu do të bëhet!





## Haskuka inspekton punimet infrastrukturore në rrugën “Mehmet Hasi”

PRIZREN, 30 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, të premtën, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike, Osman Krasniqi, kanë inspektuar punimet infrastrukturore, të realizuara në rrugën “Mehmet Hasi” në lagjen Tusus. Për shkak të reshjeve të mëdha dhe ujërave sipërfaqësore, në këtë rrugë është bërë ndërtimi i kanalizimit atmosferik me gjatësi 398 metra, si dhe pjesa

ku është punuar për këtë kanalizim, ku edhe rruga ekzistuese ka qenë mjaft e dëmtuar, është shtruar me asfalt, në gjatësi prej 305 metrash dhe gjerësi 6,4 metra. Përveç kësaj, në njërin anë të kësaj rruge është duke u punuar edhe për rregullimin e trotuarit në gjerësi prej dy metrash. Kjo rrugë është mjaft e rëndësishme meqë mundëson lidhjen me Hoçën e Qytetit (me rrugën e vjetër), e cila është në ndërtim e

sipër, kështu që qytetarët e këtij rajoni do të kenë mundësi që të arrijnë shumë më shpejt në këtë fshat. Po ashtu, në të ardhmen, pas realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo rrugë do të mund të lidhet edhe me rrugën kryesore Prizren - Kukës. Me këtë rast Haskuka ka theksuar se me rregullimin e kushteve atmosferike, tanimë do të vazhdojë punimet edhe nëpër rrugë të tjera të shumta të Komunës së Prizrenit.



## Në Gjilan në dhjetëditëshin e fundit situata me Covid është më e qetë



GJILAN, 30 PRILL (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilan ka mbajtur të premtën takimin e radhës të udhëhequr nga nënkryetari Arbër Ismajli për vlerësimin e situatës për dy ditët e fundit. Në konferencën për media, nënkryetari Ismajli ka thënë se situata me Covid-19 në dhjetëditëshin e fundit është

më e qetë. “Kanë filluar dukshëm të ulen shifrat. Nga mbi 700 raste aktive para pak javësh, numri bie në 243, ndërkaq nga afro 75 vizita shtëpiake nga ekipet e shëndetësisë primare, numri është ulur në 30”, ka thënë Ismajli. Ai ka bërë me dije se deri tani janë vaksinuar 1 377 qytetarë, aq sa ka qenë numri i dozave për këtë komunë. Në

fazën e parë është vaksinuar personeli shëndetësor dhe grupmoshat 85, 80 dhe 75 vjeç. Pasqyra e përgjithshme në Gjilan që prej fillimit të pandemisë është si vijon: nga 20 274 mostra, 6 274 kanë rezultuar pozitivë, 5 892 janë shëruar, 139 qytetarë e kanë humbur betejën nga virusi, 243 raste janë aktive dhe të hospitalizuara me Covid janë 43 raste.

## Lladrovci dhe përfaqësues të kompanisë së Feronikelit nënshkruajnë marrëveshje

DRENAS, 30 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, drejtori i Shkollës së Mesme Profesionale, Lulzim Nika dhe përfaqësuesi i kompanisë së Feronikelit, Genc Beribashi, kanë nënshkruar memorandum të bashkëpunimit për t'u mundësuar nxënësve të kësaj shkolle kryerjen e praktikës në këtë ndërmarrje. Kryetari Lladrovci ka falënderuar përfaqësuesin e Feronikelit, Genc Beribashi, për bashkëpunimin e treguar

ndër vite të kompanisë për t'u ofruar nxënësve mundësi për përbushjen e kompetencave profesionale përmes pjesëmarrjes në ambient real të punës për ta kryer pjesën e praktikës profesionale me elemente të sistemit dual në kompani. Edhe përfaqësuesi i kompanisë, Beribashi, ka thënë se ndihet i lumtur që përmes kësaj përkrahje u jep mundësi nxënësve që ta profesionalizojnë në punë praktike drejtimin e tyre.



## Kuvendi Komunal i Gjakovës i jep mbështetje financiare organizatës “Hendikos”

GJAKOVË, 30 PRILL (ER) - Të premtën është mbajtur mbledhja e katërt për vitin 2021 e Kuvendit të Komunës së Gjakovës. Anëtarët e kuvendit kanë diskutuar dhe miratuar të gjitha pikat e rendit të ditës, të propozuara nga kryesuesi Anton Shala. Fillimisht anëtarët e Kuvendit kanë parashtruar pyetje për kryetarin e komunës, Ardian Gjini dhe drejtorët komunalë, për tema dhe aktivitete të ndryshme në Komunën e Gjakovës. Më tej, nga ana e drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Durim

Halilaj, është prezantuar dhe ka kaluar unanimitisht shpërndarja e rezervës buxhetore për vitin 2021 si dhe është paraqitur informata e parë periodike financiare për periudhën janar-mars 2021. Më tej është shqyrtuar dhe miratuar propozimi për mbështetjen financiare të organizatës “Hendikos” në Gjakovë, ndërsa me propozim të drejtorisë për Shërbime Publike u shqyrtuan dy dokumente nga sektori për menaxhimin e mbeturinave, draftregullorja për menaxhimin e mbeturinave

dhe draftplani komunal për menaxhimin e mbeturinave. Anëtarët e Kuvendit e kanë shqyrtuar edhe draftregulloren mbi plotësimin e kushteve minimale higjienike, teknike dhe sanitare për lokalet afariste në Komunën e Gjakovës, të propozuar nga Drejtoria për Punë Inspektuese, po ashtu u caktuan edhe anëtarët e komisionit rekrutues për pozitë e drejtorëve dhe zëvendësrejtorëve të disa prej shkollave të Komunës së Gjakovës, komision ky i kërkuar nga Drejtoria për Arsime.






# BE-ja deklarohet për pagesën e rrymës në veri, nuk lejon të shpenzohen mjetet e Fondit për Veriun

EPOKA  
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 PRILL - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti me shumicë të votave ka miratuar propozimin e Mimoza Kusari-Lilës që t'i ndahen 11 milionë euro KOSTT-it për pagesën e rrymës në veri. Lidhur me këtë temë kishte propozime se rryma në veri të paguhet nga Fondi për Veriun, fond ky i themeluar si pjesë e marrëveshjeve Kosovë - Serbi në Bruksel.

Për këtë ngjarje është deklaruar Zyra e BE-së në Prishtinë.

Në përgjigjen dhënë për gazetën "Epoka e re", Zyra e BE-së në Prishtinë ka thënë se mjetet e Fondit të Veriut mund të përdoren vetëm për investime për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik dhe për të mirën e popullatës lokale në komunat veriore. "Siç përcaktohet në Marrëveshjen e Dialogut të lehtësuar nga BE-ja mbi Grumbullimin e të Ardhurave Doganore, Fondi i Zhvillimit për Veriun e Kosovës mund të përdoret vetëm për investime për ta promovuar zhvillimin socio-ekonomik dhe për të mirën e popullatës lokale në komunat veriore. Propozimet e projekteve parashikohet të paraqiten nga katër komunat për shqyrtim nga një bord menaxhues prej



tre anëtarësh, i përbërë nga Ministri i Financave, një përfaqësues i komunitetit serb të Kosovës dhe i kryesuar nga përfaqësuesi i posaçëm i BE-së", është thënë në përgjigjen e Zyrës së BE-së dhënë për gazetën "Epoka e re".

Ndërkaq vitin e kaluar Fondi i Zhvillimit për Veriun kishte në dispozicion 3.5 milionë euro, kurse këtë vit ka mbi 2 milionë euro. "Vitin e kaluar Fondi i Zhvillimit ndau 3.5 milionë euro për ndërtimin e një qendre kulture në Mitrovicën Veriore. Aktualisht ka mbi 2 milionë euro në dispozicion për financimin e projekteve të

reja të investimeve publike në katër komunat veriore", është thënë në përgjigjen e Zyrës së BE-së.

Në lidhje për pagesën e rrymës në veri ka reaguar Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj).

KMDLNj ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që të gjejnë një zgjidhje të shpejtë për konsumatorët e papërgjegjshëm që nuk i paguajnë faturat për rrymën e shpenzuar dhe shërbimet e tjera komunale, në të kundërtën as konsumatorët e tjerë nuk do të duhej t'i paguanin faturat.

KMDLNj thekson se nëse shteti ua paguan rrymën dhe shpenzimet e tjera komunale serbëve në veri të Kosovës, pa e përfillur fare gjendjen e tyre ekonomike, atëherë po ky shtet duhet t'i lirojë nga pagesa kategoritë e qytetarëve në gjendje të rëndë ekonomike apo të mbulojë një pjesë të këtyre shpenzimeve. "Që nga përfundimi i luftës serbët në veri të Kosovës, por edhe në lokacionet e tjera ku jetojnë, nuk kanë paguar shpenzimet për energjinë e shpenzuar sikur edhe shërbimet e tjera komunale si faturat për ujë, mbeturina dhe të tjera. Madje

faturat për këto shërbime u janë fryrë konsumatorëve shqiptarë dhe joserbë, duke i detyruar që të paguajnë, pa dijeninë dhe pëlqimin e tyre, faturat e serbëve dhe humbjet e KOSTT-it i cili edhe tani ka kërkuar që Qeveria e Kosovës të ndajë 11 milionë euro për energjinë e shpenzuar dhe të papaguar të serbëve në veri të Kosovës. Realisht, qeveria aktuale Kurti 2 nuk e ka shkakuar këtë situatë, por se e ka trashëguar nga qeveritë e mëparshme, andaj edhe kritikata nuk e kanë efektin e duhur", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

## Mazreku: Së shpejti arrihet marrëveshja për njohjen reciproke të policave të sigurimit me Malin e Zi



PRISHTINË, 30 PRILL (ER) - Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku, ka bërë me dije se BKS-ja është në fund të negociatave për arritjen e një marrëveshje për njohjen reciproke të policave të sigurimit me Malin e Zi. Ai beson se marrëveshja e negociuar prej kohësh do të përfundojë së shpejti. "Siç ju kam njoftuar edhe ditë më parë, Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) është në fund të negociatave për arritjen e një

marrëveshje për njohjen reciproke të policave të sigurimit me Malin e Zi. Ne besojmë se marrëveshja e negociuar prej kohësh do të përfundojë së shpejti dhe ne do t'ju njoftojmë paraprakisht për kohën se kur do të hyjë në fuqi ky vendim. Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) është institucioni i vetëm përgjegjës për negociimin dhe nënshkrimin e vendimit për njohjen reciproke të policave", ka shkruar Mazreku në llogarinë e vet në "Facebook".

## Konjufca njoftohet me prioritetet e BQK-së

PRISHTINË, 30 PRILL (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premten në takim guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti. Ky i fundit ka uruar Konjufcën për përzgjedhjen

në pozitën e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Guvernatori Mehmeti e ka njoftuar Konjufcën lidhur me zhvillimet në sektorin financiar për përparimin e arritur në këtë sektor si dhe

për rëndësinë e tij në zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi.

Guvernatori Mehmeti ka përmendur edhe sfidat dhe prioritetet e BQK-së, ku Kuvendi i Kosovës është mbështetësi më i

rëndësishëm për realizimin e tyre.

Ndërkaq Konjufca e ka falënderuar guvernatorin Mehmeti për informacionin e dhënë dhe ka ofruar përkrahjen e Kuvendit për realizimin e objektivave me



interes të përbashkët institucional.



CERN dhe FERMILAB kërkojnë forcën e pestë fundamentale të fizikës, që tashmë është zbuluar nga fizikani Naim Krasniqi (6)

# Lidhshmëria në mes ligjit të gravitacionit të Isak Njutonit dhe relativitetit gjeneral të Albert Ajnshtajnit



Nga: Naim KRASNIQI, fizikan

Në botimet në "Epoka e re" në vitin 2016 shumë qartë është sqaruar se masa e një trupi qiellor ndaj një trupi qiellor është e barabartë me zero. Çka do të thotë se masa e Hënës ndaj Tokës është e barabartë me 0 (kjo do të argumentohet prapë në të ardhmen). Prapë se prapë ne do të ndalemi te fizika tradicionale ku trupat qiellorë kanë masa, ngjashëm ashtu sikur i kanë menduar dy fizikanët Isak Njuton (Isaac Newtonit) dhe Albert Ajnshtajnit (Albert Eisteinit). Nëse në mënyrë logjike i analizojmë këto dy ligje thuajse arrijmë te i njëjti përfundim.

Le t'i analizojmë dy ligjet e forcës tërheqëse në mes Tokës në të cilën jetojmë dhe Hënës që rrotullohet rreth Tokës në një distancë prej 356 511 km, qoftë përmes ligjeve të Isak Njutonit apo Albert Ajnshtajnit. a) Bazuar në ligjin e Isak Njutonit thuhet se forca tërheqëse gravitacionale në mes Tokës dhe Hënës në distancën e lartcekur është në përpjesëtim të drejtë me masat e tyre. Çka do të thotë se sa më e madhe të jetë masa e Tokës dhe Hënës aq më e madhe është forca tërheqëse, kurse b) Bazuar në ligjin e relativitetit të Albert Ajnshtajnit thuhet se sa më e madhe të jetë masa e trupave qiellorë deformimi i kohë-hapësirës është më i madh. Çka do të thotë se sa më e madhe të jetë masa e Tokës dhe e Hënës aq më shumë deformohet kohë-hapësira dhe aq më shumë provokohet rritja e forcës gravitacionale. (Shiko figurën 1.)

## Sqarim

Siç po shihet i gjithë rezultati i forcës tërheqëse gravitacionale qoftë sipas ligjit të Isak Njutonit apo Albert Ajnshtajnit varen nga masa e trupave qiellorë. Çka do të thotë se janë ligje të ngjashme por që interpretohen në mënyra

të ndryshme. Prandaj nën ndikimin e forcës tërheqëse në të dy rastet Hëna do të përplasej për Tokë sepse kemi vetëm forcë tërheqëse dhe nuk ekziston asnjë forcë e identifikuar repulsive.

## Relativiteti gjeneral i Albert Einsteinit, shembull i parë i thjeshtë

Ne nuk do të hyjmë te shembujt e forcës gravitacionale të Isak Njutonit, por do ndalemi më shumë te relativiteti gjeneral i Albert Ajnshtajnit i cili është më aktual.

Sipas teorisë gjenerale të relativitetit kohë-hapësira përbëhet prej katër dimensioneve, tri dimensione janë të hapësirës x,y, dhe z, kurse dimensionin e katërt është koha. Edhe për dallim që teoria gjenerale e relativitetit ku hapësirën e konsideron katër dimensionale, ne mund të kryejmë eksperimente me kohë-hapësirën vetëm me dy dimensione. Për këtë arsye le ta marrim një pëlhurë të hollë elastike dhe e vendosim mbi një enë. Në rastin e parë e marrim një sferë të magnetizuar që ka një masë (m1) dhe e lëshojmë në mes të pëlhurës, pasi pëlhura është elastike do të vërtetohet eksperimentalisht se sfera e lakon pëlhurën në mes duke e formuar një hapësirë të lakuar. Pas kësaj e marrim një sferë nga metali dhe e lëshojmë në pjesën e skajshme të enës mbi të cilën është vendosur pëlhura figura (1). Do të vërtetojmë se sfera e hekurit nuk do ta përkulë pëlhurën e të mbetet në skaj të enës, as nuk do të shkojë anash por do të rrëshqasë dhe do të shkojë në drejtim të pjesës më të madhe ku është përkulur pëlhura elastike. Do të thotë, do të shkojë drejt sferës magnetike nga fakti se aty është lakuar më së shumti pëlhura. (Shiko figurën 2.)

## Shembulli i dytë i thjeshtë

Tani në rastin e dytë, ashtu ngjashëm sikur në rastin e mëparshëm do të marrim dhjetëra sfera të vogla dhe do të lëshojmë nga të gjitha anët në skajet e pëlhurës. Në të njëjtën

mënyrë do të vërtetojmë se asnjëra nga sferat nuk do ta përkulë pëlhurën e të mbetet në vendet ku janë lëshuar, por do të ndjekin pjerrtësinë e pëlhurës të gjitha sferat, dhe në fund do të përfundojnë afër sferës së magnetizuar nga fakti se masa e sajë ishte më e madhe si dhe e ka lakuar pëlhurën elastike më shumë në mes të enës. (Shiko figurën 2.)

Në këtë mënyrë sikur Dielli të ishte në gjendje të ngurtë ashtu sikur është tani Toka, atëherë të gjithë trupat qiellorë, satelitët natyral dhe asteroidët, duke përfshi edhe asteroidët në rripin e Kuiperit do të bashkoheshin në qendër aty ku do ishte përkulur hapësira për shkak të masës së diellit. (Shiko figurën 3.)

Dhe asnjëherë nuk ndodhë që sfera e vogël, apo sferat e vogla ta përkulin hapësirën në vendet ku janë lëshuar, por as nuk ndodhë të kthehet pas dhe të ngritët mbi pëlhurë e të largohet nga ena. Kjo nuk ndodhë sepse natyra nuk e lejon. Prandaj shtrohet pyetja si e lejon natyra që dielli ta përkul hapësirën e trupat e tjerë qiellorë të mos përplasen për të. Pra edhe në këtë rast te Albert Ajnshtajnit pasi është thënë se forcën gravitacionale e provokon përkulja e kohë-hapësirës, pse nuk është dhënë shkalla e elasticitetit të hapësirës, sepse masa e trupave qiellorë e konsumon elasticitetin e kohë-hapësirës, kështu nuk kemi një elasticitet të kohë hapësirës përreth trupit që e ka shkaktuar atë deformim të kohë-hapësirës. Pra siç po shihet as Albert Ajnshtajni nuk ka lënë hapësirë për forcë shtytëse në mes trupave qiellorë. Nga ana e tjetër thuhet se energjia e zezë si një forcë antigravitacionale është e shpërndarë në mënyrë uniforme në tërë hapësirën e universit, dhe kjo shpërndarje uniforme i kundërvihet forcës tërheqëse në mes trupave qiellorë. Tani nëse kjo energji negative e shpërndarë në mënyrë uniforme në tërë universin do ta kundërshtonte forcën tërheqëse, me ç'rast do ta parandalonte goditjen e trupave qiellorë, tani shtrohet pyetja si ka mundësi trupi qiellorë të rrotullohet rreth një trupi qiellorë duke kaluar përtej kësaj energjie negative, duke e marrë parasysh se këndi i lakimit të




Figura 1




Figura 2



Figura 3




Figura 4

hapësirës është i lakuar (në eksperiment 7°), kurse këndi i lëvizjes rrethore është i drejtë (0°). Prandaj forca tërheqëse gravitacionale do ta shpejtonte rrotullimin e trupit në hapësirën e lakuar drejt qendrës, por nuk do kishte mundësi për ta rrotulluar trupin rreth vetes. (Shiko figurën 4.)

Kjo nuk ka asnjë logjikë shkencore jo të ndodhë por as që duhet të mendohet. Por gjërat do të komplikohen edhe më

shumë te energjia e zezë, sepse nëse lakohet hapësira atëherë vije pyetja se si do të lakohet energjia e zezë, sepse nëse nuk dihet se prej cilave grimca është krijuar hapësira, si mundemi ta imagjinojmë që është lakuar kohë-hapësira. Këto janë imagjinata dhe do të duhet një bazë shkencore që do ta vërtetonte ndonjë fenomen natyror, që ne të ishim në gjendje ta sqarojmë.

(Vijon)





Hysen Beqa lindi në Mollë të Gjakovës. Ka mbaruar studimet për shkencë politike dhe administratë publike në Universitetin e Prishtinës. Beqa është autor i romanit "Misiri i vogël", i cili nga gjuha shqipe është përkthyer në gjuhën angleze, franceze, gjermane, italiane dhe polake. Ky është libri i tij i dytë.

Ky libër, në rrafshin tematik, është vazhdim i romanit *Misiri i vogël*, i po të njëjtit autor, botuar tri vjet më parë, në të cilin autori përsiat për veten, për shoqërinë, për botën që e rrethon.

Këtë libër herë e lexojmë si fikcion, herë tjetër si jetëshkrim. Brenda tekstit gjejmë shenja të autorit, por edhe të narratorit. Ato që i rrëfen narratori janë ide të autorit, janë pikëpamje të tij për individët dhe shoqërinë. Heroi i romanit gjendet para shumë dilemave të mëdha të cilat ia krijon shoqëria.

Në këtë libër autori trajton fatin e shkrimtarit dhe ballafaqimin e tij me shoqërinë. Përmes ndodhjeve personale, del sheshit fati i shkrimtarëve në shoqërinë e Kosovës. Nëse dikur shkrimtari ishte prijës popullor, sot ai është shtresë e harruar nga shoqëria madje, nëpërmjet gojës së narratorit homodiegetik, shkrimtarët konsiderohen të çmendur dhe janë ose bëhen objekt talljeje. Por, nëpërmjet stoicizmit të narratorit Beqa mëton të tregojë se shkrimtaria nuk është thjesht një profesion a pasion, por mision.

Në këtë libër do të lexoni për politikën dhe për politikanët. Nuk do ta hasni autorin duke bërë politikë. Edhe pse nuk përmend emra të politikanëve dhe të politikave të këqija, është mjaft konkret, sepse përmend specifika të tyre. Këto raste të trajtuara për lexuesin semantik janë thjesht ide personale, kurse për lexuesin semiotik më tepër se kaq.

*Albin Mehmeti*

5.99€



ISBN 978-9951-780-53-7

SHKRIMTARI

HYSEN BEQA

HYSEN BEQA



Kaltrina Pacolli  
Prishtinë

Zërin ngrite deri te Zoti.

Jetën mos ia fal askujt, përpos vetes.

Ti vlen sa gjithë bota, dhe bota pa ty është e mjerë.

Ti që botës i dhuron jetë, askush nuk ka të drejtë ta marrë atë nga ti.

Bërtit! Fol! Thuaje!

Unë jam gruaja më e fortë në botë!

ISBN 978-9951-780-49-0



9 789951 780490

6.99€




PRISHTINA



ARMAGEDONI

# UNË, KUFOMA E ARDHSHME



Kaltrina Pacolli





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

# YLLI, AFËR FINALES. PEJA NË EPËRSI NDAJ PONTE PRIZRENIT



**Prishtinë, 30 prill** - Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore ndaj Rahovecit 77:68 (22:17, 21:15, 19:22, 15:14) në gjysmëfinalen e tretë të "play-off"-it të FIVE STAR Superligës së Kosovës në basketboll. Skuadra nga Theranda është në epërsi 2:1, derisa kush shënon tri fitore do të kualifikohet në finalen e madhe. Takimi i radhës zhvillohet të dielën, po ashtu në Therandë. Vendasit kishin një epërsi të lehtë në çerekun e parë, që e përfundojnë në të mirë të tyre 22:17. Mysafirët barazuan shifrat në 24:24, por më pas nis shkëputja e vendasve që arritën epërsi deri në 11 pikë, 41:30, kurse pjesa e parë përfundon 43:32. Therandasit vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e tretë, duke pasur epërsi 14 pikë, 48:34, por më pas Vreshtarët hyn në një seri të suksesshme, duke afruar

rezultatit në 58:53, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 62:54. Loja dramatike u zhvillua në 10 minutat e fundit me skuadrën mysafire që afro rezultatin në 69:68, dy minuta nga fundi, por në çastet vendimtare, Ylli u tregua më i vëmendshëm dhe triumfoi 77:68. Te Golden Eagle Ylli u dalluan Gëzim Morina me 17 pikë e 10 kërcime dhe Elyjah Clark me 25 pikë e 7 kërcime, kurse te Rahoveci u dalluan Ed Daneil me 19 pikë e 13 kërcime dhe Darell Davis me 18 pikë. Peja ka shënuar fitore ndaj Ponte Prizrenit 108:85 (30:22, 22:18, 30:16, 26:29) në ndeshjen e tretë gjysmëfinale të "play-off"-it në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Ndeshja ka qenë mjaft e bukur, derisa pejanët tani kryesojnë 2:1, kurse skuadra që shënon tri fitore do të kualifikohet në finalen e

madhe. Vendasit e nisën më mirë ndeshjen, duke pasur 12 pikë epërsi në çerekun e parë 26:14, derisa kjo pjesë përfundon 30:22. Verdhezinjtë epërsinë më të lartë në pjesën e parë e arritën 41:22, por më pas këndellen prizrenasit, kurse pjesa e parë përfundon 52:40. Pejanët nuk u ndalën as në periodën e tretë, për të vazhduar dominimin, ndërsa në këtë pjesë arritën epërsi deri në 26 pikë, 80:54, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 82:56. Epërsinë e krijuar e ruajti Peja dhe triumfoi në fund 108:85. Te Peja u dalluan Brandon Walters me 29 e 17 kërcime, Dardan Berisha me 22 pikë e 8 asistime dhe Lis Shoshi me 17 pikë e 8 kërcime, kurse te Ponte Prizreni u dallua Këame Vaughn. Ndeshja e katërt gjysmëfinale do të zhvillohet të enjten në Pejë.

## SHKURT

**Sinani: Askush nuk ka të drejtë të ma humbë nderin dhe djersën**

Futbollisti i Ballkanit, Egzon Sinani, është futbollisti që është fyer nga tifozët llapjanë pas ndeshjes Ballkani - Llapi. Futbollisti Sinani është "kërcënuar" se nuk është i mirëpritur në vendlindje. Ndjaj këtyre sulmeve ka reaguar Sinani: "Askush nuk ka të drejtë të ma humbë nderin dhe djersën që kam bërë për ekipin e vendlindjes sime. Jam krenar që kam bartur fanellën e këtij ekipi!"

**Lazio planifikon transferimin e Shaqirit**

Futbollisti shqiptar i Liverpoolit, Xherdan Shaqiri, pritet të largohet nga "Anfield" në afatin kalimtar të verës. 29-vjeçari mund të rikthehet në Serinë A, pasi është skuadra e Lazios ajo që ka shfaqur interesim për shërbimet e tij. Nëse arrihet marrëveshja, klubit italian i duhet të paguajë 14 milionë euro. Shaqiri gjatë karrierës së tij ka luajtur edhe për Interin, Bayern Munchenin, Stoke Cityn dhe Baselin.

**Ramosi pranon uljen e pagës për të mbetur në Real**


Sergio Ramos mund të mbetet ende pjesë e Real Madridit. Lajmi raportohet nga mediat spanjolle, sipas të cilave, kapiteni po merr në konsideratë ofertën e klubit, që parashikon rinovimin me ulje page. Ramosi mësohet se ka udhëzuar menaxherin e tij që të negociojë sërish me Perezin dhe ta pranojë ofertën për shkurtim page, me kushtin që kontrata e re të ketë vlerë deri në verën e 2023-shit, pasi mbrojtësi synon të marrë pjesë edhe në Botërorin e Katarit më 2022. Pak javë më parë kapiteni i Los Blancos refuzoi ta ulë pagën dhe paralajmëroi se do të largohej nga "Santiago Bernabeu", por duket se mungesa e ofertave joshëse nga klube të tjera evropiane ka bërë që të tërhiqet pas.

## Kosova në grup me Shqipërinë për Botërorin 2023

**NION, 30 PRILL** - Të premtën në Nion është tërhequr shorti për kualifikimet e Kupës së Botës "Zelanda e Re - Australia 2023" për kombëtaret e femrave. 51 ekipet pjesëmarrëse në këto kualifikime janë ndarë në 9 grupe, gjashtë grupe me nga 6 ekipe dhe tri grupe

me nga 5 ekipe. Kosova u përfshi në grupin F, ku bën pjesë edhe Shqipëria, ndërkaq pjesë e këtij grupi janë edhe Norvegjia, Belgjika, Polonia dhe Armenia. Ndeshjet e këtij cikli kualifikues fillojnë në shtator të këtij viti, kurse përfundojnë në shtator të vitit 2022.

Ndeshjet luhen me sistem vajtje-ardhje. Fituesit e nëntë grupeve kualifikohen drejtpërdrejt në Botërorin 2023, derisa skuadrat e renditura në pozitën e dytë do të luajnë në "play-off" për t'u përcaktuar dy ekipet e tjera që do të kualifikohen në Botëror.





## Serena Williamsi refuzon Madridin, synon triumfin në Roland Garros

Washington, 30 prill - Tenistja amerikane Serena Williams, pasi vendosi të mos luajë në turneun Masters të Majemit, në turnetë e Montekarlos dhe Barcelonës, vendosi të mos

zbrësë në fushë as në turneun Masters të Madridit, që nisi të enjten. Numri 8 në botë nuk luan që prej grand slamit të Australian Openit dhe pritet të rikthehet në fushë në mesin e

majit. Trajneri i saj, Patrick Mouratoglou, ka deklaruar: "Serena po bëhet gati për debutimin e saj në fushat me dhe. Besoj se do të rikthehet të luajë në turneun e Romës dhe

më pas në Roland Garros. Objektivi i saj do të jetë triumfi në grand slamit parisien. Gjatë kësaj periudhe do të stërvitet në Nisë të Francës për të qenë gati".



## Sot derbi Drita - Feronikeli, nesër Llapi - Prishtina

PRISHTINË, 30 PRILL (ER) - Derbi kryesor i javës së 32-të në Superligën e Kosovës në futboll në mes të Dritës dhe Feronikelit do të zhvillohet sot (e shtunë). Kjo ndeshje do të jetë jashtëzakonisht interesante për faktin se kampionët e Dritës synojnë tri pikët e plota në mënyrë që të mos humbasin hapin për titull dhe t'u rikthehen fitoreve pas barazimit që morën në mesjavë kundër Besës në Pejë. Drita ka rënë në pozitën e tretë dhe tash ka dy pikë më pak se Ballkani dhe një pikë më pak se Prishtina. Në anën tjetër, "Nikli" renditet në vendin e gjashtë me 35 pikë të grumbulluara, do të mundohet që në këtë ndeshje të marrë pikë dhe t'i ikë zonës së rrezikshme. Sot pikë kërkon edhe Arbëria në përballje me Gjilanin, pasi kjo skuadër me fitoren ndaj Feronikelit ka hyrë seriozisht në garë për mbijetesë. Në anën tjetër, Gjilani është komod në vendin e katërt. Ndeshja e tretë sot (e



**SUPERLIGA - Java 32**

**Të shtunën takohen:**  
15:00 Drita - Feronikeli  
15:00 Trepça '89 - Besa  
15:00 Arbëria - Gjilan

**Të dielën takohen:**  
15:00 Llapi - Prishtina  
15:00 Bronica - Ballkani

shtunë) zhvillohet në Mitrovicë në mes të Trepçës '89 dhe Besës. Mitrovicasit duhet të jenë të kujdesshëm ndaj ekipit pejan, i cili po luan pa presion dhe po u nxjerr mjaft telashe skuadrave kundërshtare. Të dielën zhvillohet derbi i dytë i kësaj xhiroje mes Llapit dhe Prishtinës në stadiumin "Zahir Pajaziti". Prishtina do të mundohet që ta ruajë formën e mirë dhe

ta ndjekë titullin e kampiones, derisa Llapi nuk ka ndonjë ambicie të madhe në kampionat, pasi është përqendruar maksimalisht në garën e Kupës. Ndeshje interesante do të zhvillohet në Skenderaj në mes të Drenicës dhe Ballkanit. Kuqezinjët kërkojnë pikët për mbetjen në Superligë, kurse suharekasit për titull e kampionit.

## Fitojnë Brooklynin dhe Dallasi

INDIANAPOLIS, 30 PRILL - Brooklyn Nets blindon pozitën në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes, pasi ka mposhtur Indiana Pacers në "Life Fieldhouse" të Indianapolisit me rezultatin 113-130, duke regjistruar kështu suksesin e katërt radhazi dhe të 43-tin në 63 ndeshje. Të udhëhequr nga Kevin Durant në formë spektakolare, miqtë nuk e vunë për asnjë moment në diskutim fitoren, duke fituar bindshëm të tre fraksionet e para të lojës dhe duke ulur disi ritmin vetëm në pjesën e fundit. Nga ana tjetër 32-vjeçari Durant e mbylli ndeshjen me 42 pikë të shënuara, 3 topa të rikuperuar dhe 10 asistime, ndërsa për Pacersin bëri një ndeshje të mirë kanadezi LeVert me 36 pikë, 4 rikuperime dhe 5 asistime. Vijnë të bëjë mirë edhe Dallas Mavericksi, që triumfoi me rezultatin 105-115 në transfertën ndaj Detroit Pistonsit dhe tani e sheh veten gjithmonë e më të sigurt në zonën "play-off" të



**REZULTATET**

Detroit - Dallas	105-115
Indiana - Brooklyn	113-130
Houston - Milwaukee	143-136
Minnesota - Golden State	126-114
Denver - Toronto	121-111
Oklahoma - New Orleans	95-109

renditjes në Konferencën e Perëndimit. Pas një pjese të parë të balancuar, Mavericksi mori kontrollin e lojës në fraksionet e tjera, falë edhe një ndeshjeje të përkryer nga ana e Tim Hardaway, që e mbylli ndeshjen me 42 pikë të shënuara, një rikuperim dhe 3 asistime. Një nga sfidat më

interesante të mbrëmjes ishte edhe ajo në mes të Houston Rocketsit dhe Milwaukee Bucksit, që u fitua nga vendasit me rezultatin 145-136. Në "Toyota Center" ishin miqtë nga Milwaukee që e nisën mirë ndeshjen, por më pas në skenë u ngjiti 20-vjeçari Kevin Porter që bëri një paraqitje magjike me 50 pikë të shënuara, 5 rikuperime dhe 11 asistime. I transferuar te Houston Rockets vetëm në janar të këtij viti, Porteri konfirmoi se është një nga yjet e rinj të basketbollit, pasi u bë futbollisti më i ri në historinë e NBA-s që shënon 50+ pikë dhe 10+ asistime në një ndeshje të vetme. Në sfidat e tjera, Denver Nuggetsit triumfoi me rezultatin 121-111 ndaj kanadezëve të Toronto Raptorsit, Minnesota Timberwolves mposhti 126-114 ndaj Golden State Warriorsit, ndërsa Oklahoma City Thunderi ra në shtëpi me rezultatin 95-109 ndaj New Orleans Pelicansit.

### SHKURT

#### Hamiltoni: Dëshiron të garojë edhe në vitin 2022

Në prag të garës së Portugalisë, që zhvillohet këtë fundjavë, Lewis Hamilton, ka larguar çdo dyshim në lidhje me të ardhmen e tij. Kontrata e pilotit britanik me Mercedesin skadon në fund të këtij viti, por shtatë herë kampioni i botës në Formula 1 dëshiron të garojë edhe në vitin 2022. Ai synon të bëhet piloti më i suksesshëm në historinë e këtij sporti, duke kaluar Michael Schumacher. "Dua të vazhdoj të garoj edhe vitin tjetër, të fitoj sërish. E ardhmja mund të rezervojë të tjera surpriza të bukura për mua. Zakonisht nuk bëhem vullnetar, por këtë herë jam gati. Dua ta ndihmoj Pirellin që të krijojë një produkt më të mirë në pistë. Gjithsesi, për momentin jam fokusuar te ky sezon dhe te dueli me Verstappen, pasi do të jetë një sfidë e bukur", ka thënë Hamiltoni.

#### Guardiola: Messi nuk do të gjejë kurrë një vend më të mirë sesa Barcelona

Tifozët e Barcelonës po presin me padurim rinovimin e Leo Messit. Ylli argjentinas ndodhet në vitin e fundit të kontratës, teksa rikthimi i Joan Laportës në krye të klubit katalanas ka rikthyer shpresat e zgjatjes së bashkëpunimit me kapitenin. TVË ka transmetuar një dokumentar për "pleshtin", rreth të cilit flet edhe Pep Guardiola. Trajneri i Manchester Cityt, një katalana puro dhe një adhurues i madh i Leo Messit, uron që ky i fundit të mos largohet nga "Camp Nou". "Shpresoj që Messi ta mbyllë karrierën te Barcelona. Ai nuk do të gjejë kurrë një vend më të mirë sesa aty ku ndodhet aktualisht", ka deklaruar trajneri i Manchester Cityt, një ndër klubet e interesuara për 33-vjeçarin nga Rosario.

#### Pogba, pas fitores 6-2: Asgjë nuk ka mbaruar

Manchester Unitedi e mposhti Romën në Ligën e Evropës me rezultat 6-2, por mesfushori Paul Pogba ka thënë se asgjë nuk ka përfunduar. "Rezultati është pozitiv, por asgjë s'ka mbaruar. Duhet të qëndrojmë të fokusuar dhe të bëjmë ndeshje të mirë me të njëjtin mentalitet. Në pjesën e parë bëmë dy gabime dhe pranua dy gola", ka thënë Pogba. "Pas pjesës së parë diskutuam dhe thamë që duhet t'i bëjmë gjërat në mënyrë të duhur dhe thjeshtë. Foli edhe trajneri dhe të gjithë ishim të motivuar që të shënonim sa më shumë gola që ishte e mundur", ka shtuar Pogba.

#### Unitedi dhe Zeniti kërkojnë Umtitin

Mbrojtësi i Barcelonës, Samuel Umtiti, mund të largohet nga "Camp Nou". Francezi e ka humbur prej kohësh vendin e titullarit dhe nuk shihet nga trajneri Koeman si lojtar ku mund të bazohet për sezonin e ardhshëm ndaj dhe shitja e tij është e pashmangshme. Një prej ekipeve të interesuara është Manchester Unitedi që nuk e ka si prioritet, por nëse do të dështonte me Varanen, atëherë do ta shihte francezin si një opsion. Zeniti është, gjithashtu, ekip i interesuar dhe që ka pasur më shumë kontakte me agentin e Umtitit, dhe është në gjendje të ofrojë 15 deri në 20 milionë euro për kartonin e tij.

## Finalja e Kupës së Italisë do të luhet me tifozë

Shumë shpejt edhe në Itali do të shohim tifozë. Finalja e Kupës së Italisë mes Atalantës dhe Juventusit, e planifikuar për t'u zhvilluar më 19 maj në "Mapei", në Reggio Emilia, do

të jetë e hapur për publikun për një maksimum prej 20 % të kapacitetit të stadiumit. Vendimi u njoftua nga nënsekretari i Shëndetësisë, Andrea Costa: "CTS aktualisht po studion

protokollin për t'i lejuar spektatorët ndjekjen e ndeshjes në mënyrë të sigurt, në përputhje të plotë me protokollin anti-Covid". Vendimi vjen dy javë pas miratimit

nga autoritetet e pranisë së spektatorëve në tribunat e stadiumit "Olimpico" për "Euro 2020", kusht që UEFA e konsideroi thelbësor për konfirmimin e Romës si qytet pritës.





**N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.**  
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.  
e-mail.. [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)  
[www.pallatirinise.com](http://www.pallatirinise.com)

Në bazë të dispozitave të nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, respektivisht dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 si dhe Ligjit nr. 05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, si edhe në bazë të nenit 23 dhe 26 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datë: 16.04.2021, mori vendim të publikojë:

## KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i pozitës: **Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit**

### 1. Kualifikimet dhe përgatitja profesionale:

- Të posedojë diplomë universitare- Fakulteti ekonomik, nga Fusha e Financave/kontabilitetit. (Ekonomist i diplomuar ose master në shkencë ekonomike);
- Të posedojë përvojë profesionale mbi (5) pesë vite nga fusha e financave dhe kontabilitetit;
- Të ketë shkathtësi kompjuterike, posaçërisht mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
- Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);

### 2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

#### Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Organizon udhëheq dhe kontrollon punën e departamentit financiar;
- Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Përcjell dispozitat financiare në fuqi dhe literaturën profesionale dhe mban përgjegjësi nëse nuk aplikohen ligjet në fuqi;
- Kujdeset për pasurinë e ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve, kontrollon hyrje -daljet financiare në përgjithësi;
- Përcjell gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;
- Përgatit llogaritë periodike dhe përfundimtare;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;
- Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësi;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitete si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
- Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në kompani, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Të përgatis të dhënat e ndërmarrjes për auditim;
- Mbanë përgjegjësi për kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve të pasurisë së Ndërmarrjes;
- Përgatit raportet periodike dhe vjetore të Ndërmarrjes për KE dhe Bordin e Drejtorëve.
- Ushtron kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes, pagesën e obligimeve Ligjore dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- ZKFTH i raporton KE-së si dhe Bordit të Drejtorëve;
- Kryen edhe punë të tjera, për të cilat autorizohet nga KE dhe Bordi i Drejtorëve.

### 3. Informatë për procedurën e konkurimit

Aplikantët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:

- Formulari i aplikimit;
- CV;
- Letër motivimi;
- Dëshmi mbi kualifikimin profesional;
- Dëshmi mbi përvojën e punës dhe shkollimit;
- Certifikatë që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre muaj);
- Kopje e letërnjoftimit;
- Deklarata nën betim;
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

Të interesuarit mund t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre me dokumentet tjera relevante në arkivin e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë, Rr. Luan Haradinaj p.n.r., Prishtinë, duke filluar nga data **01.05.2021 deri me datën 31.05.2021**, çdo ditë pune prej orës **8:30 – 15:30**, të adresuara për: "Bordin e Drejtorëve" të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.

**Formulari për aplikim, Lista e Dokumenteve të dorëzuara dhe Deklarata nën betim**, mund të shkarkohen nga [web-faqja](http://www.pallatirinise.com/) e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinise.com/> ose mund të merren në zyrat e Ndërmarrjes.



NPL Pallati i Rinisë sh.a Prishtinë

Sukladno odredbama članka 21. Zakona br. 03 / L-087 o javnim poduzećima, odnosno odredbama članka 13. Zakona br. 04 / L-111 kao i Zakon br. 05 / L-009 o javnim poduzećima, kao i sukladno člancima 23. i 26. Statuta, Upravni odbor N.P.L. MLADI PALACE dd sa sjedištem u Prištini, na sastanku održanom: 16.04.2021, odlučio objaviti:

## K O N K U R S

ZA popunjavanje posla

Naziv radnog mjesta: glavni direktor za financije i riznicu

1. Kualifikacije i stručno osposobljavanje:

- Posjedovati sveučilišnu diplomu - Ekonomski fakultet, u području financija / računovodstva. (Diplomirani ekonomist ili magistar ekonomije);
- Posjedovati profesionalno iskustvo tijekom (5) pet godina u području financija i računovodstva;
- Posjedovati računalne vještine, posebno na naprednim sustavima u području financija / računovodstva;
- Ispuniti kvalifikacijske uvjete prema članku 17.1, kao i ispuniti kriterije neovisnosti prema članku 17.2 točke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03 / L-087 javnih poduzeća i izmjenama i dopunama LNP-a br. 04 / L-111 članak 13;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);

2. Glavne dužnosti i odgovornosti:

Glavni direktor za financije i riznicu ima sljedeće dužnosti i odgovornosti:

- odgovoran je za provedbu svih finansijskih odredbi i računovodstvenih standarda, važećih zakona na Kosovu koji reguliraju finansijska pitanja i normativnih akata poduzeća;
- Organizira, vodi i kontrolira rad finansijskog odjela;
- snosi odgovornost za plaćanje finansijskih obveza u skladu s finansijskim propisima;
- Održava točnu evidenciju i dokumentaciju za ulaganja i plaćanja poduzeća;
- slijedi važeće finansijske odredbe i stručnu literaturu i odgovoran je ako se ne primjenjuju važeći zakoni;
- brine se o imovini poduzeća, prati rad komisija, kontrolira finansijske priljeve i odljeve općenito;
- prati finansijsku situaciju u bankama i surađuje s bankarskim institucijama i drugim tijelima u interesu poduzeća;
- priprema periodične i završne račune;
- odgovoran je za pripremu bankovnih transfera ili plaćanja s pratećom dokumentacijom i osigurava EK da je plaćanje uredno;
- Dizajnira, provodi i kontrolira provedbu finansijskih postupaka od strane podređenih;
- odgovoran je za kontrolu pravilnog održavanja arhive računovodstvene i finansijske dokumentacije;
- Razvija i provodi pravila interne kontrole, kao i smjernice i postupke za aktivnosti poput upravljanja proračunom, upravljanja imovinom i obvezama i knjigovodstva;
- odgovoran je za pravilnost procesa u računovodstvenoj funkciji u poduzeću, priprema i provodi računovodstvene postupke u skladu s važećim zakonima na Kosovu, kao i kompetentno upravlja finansijskim resursima tvrtke u okviru važećih zakona i propisa;
- Priprema podataka poduzeća za reviziju;
- snosi odgovornost za obavljanje upisa i usklađivanje imovine Poduzeća;
- Priprema periodična i godišnja izvješća poduzeća za EK i odbor direktora.
- vježba brigu o izvršavanju troškova Poduzeća, plaćanju zakonskih obveza i poslovanju Poduzeća;
- NFCO izvještava EK i Upravni odbor;
- Obavlja druge zadatke za koje je ovlašten od strane EK i Upravnog odbora.

3. Podaci o natječajnom postupku

Kandidati zainteresirani za ovaj posao moraju priložiti sljedeće dokumente:

- Obrazac zahtjeva;
- životopis;
- Motivacijsko pismo;
- Dokazi o profesionalnoj kvalifikaciji;
- Dokazi o radnom iskustvu i školovanju;
- Potvrda koja nije pod istragom (ne starija od tri mjeseca);
- Kopija osobne iskaznice;
- Žalbeni spis;
- Popis predanih dokumenata.

Zainteresirani svoje prijave s ostalim relevantnim dokumentima mogu podnijeti tvrtki N.P.L. MLADI PALACE dd sa sjedištem u Prištini, Rr. Luan Haradinaj p.n.r., Priština, počevši od 01.05.2021. Do 31.05.2021., Svakog radnog dana od 8:30 - 15:30, adresirano na: "Upravni odbor" N.P.L. MLADI PALACE dd sa sjedištem u Prištini.

